



Nr. 14/1 Prot
25/04/2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

VENDIM

Nr. 12 datë 25/04/2017

Për miratimin e lejes “ Për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin” , zona Krasta e vogël , Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan, subjektit “AGED” shpk.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, neni 65, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me Nr. 309, datë 31.05.2016, për “Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Identifikimin e Nevojave për Rehabilitimin e Shtretërve të Lumenjve”, bazuar në shkresën Nr.9706 Prot, date 16.12.2016 të Ministrit të Bujqësisë ku dërgohet lista e segmenteve të miratuara për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Për miratimin e lejes “ Për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin” , zona Krasta e vogël , Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan, subjektit “AGED” shpk.

Specifikimet e zonës për rehabilitim :

Koordinatat:

Zona nr.1

X 4425471

Y 4552142

X 4425365

Y 4552356

Zona nr.2

X 4424882

Y 4552351

X 4424778

Y 4552324

Zona nr.3

X 4425296

Y 4552431

X 4424841

Y 4552394

Sip. e shfrytëzimit

0.0493 Km²

Gërmim me skreper, transport zhavorri dhe ndertim argjinate ne lartesi 3 ml në shtratin e lumit me vëllim 64,560 m³

Prurjet sipas studimit

Prurja mesatare vjetore

Q_{mes.} 60m³/sek

Prurja mesatare e muajit më të thatë

Q_{min.} 25 m³/sek

Periudha e rehabilitimit në shtratin e lumit-gjatë gjithë vitit për një periudhë 5 vjecare.

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

PËRGJEGJËS ABU

SHKUMBIN

Erald SEJDINI



KRYETARI I KBU SHKUMBIN

PREFEKTI I QARKUT

ELBASAN

Arben KAMAMI

